Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti për Funksionimin e Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës

Korrik-Shtator, 2014

Tetor, 2014, Prishtinë

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform mandatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin për vetëqeverisje lokale harton raporte periodike për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës.

Komunat, përkatësisht organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e kompetencave së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, si dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave/Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës për evitimin e veprimeve komunale të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

Prezantimi i aktiviteteve të kuvendeve të komunave është mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësisë së komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike. Ky raport përmbledh dhe shtjellon çështjet më të rëndësishme të cilat janë në mandatin e organeve të komunave, përkatësisht kuvendit të komunës dhe kryetarit të komunës. Fokusi kryesor është vënë në pasqyrimin e punës së kuvendeve të komunave, duke ditur se në mënyrë indirekte përfshinë edhe shpalosjen e punës së ekzekutivit, për faktin se ky i fundit i raporton Kuvendit në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga anëtaret e kuvendit.

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, të qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të organeve vendimmarrëse të komunave. Përmes këtij raporti krijojmë një pasqyrë të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punës dhe aktiviteteve të organeve të komunave. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës.

Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, në Republikën e Kosovës kanë funksionuar Kuvendet e 38 komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, të gjitha komunat kanë vazhduar mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun, ndërsa me qëllim të mbikëqyrjes së mbledhjeve të kuvendeve të komunave, monitorimi është bërë përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komunat veriore. Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të punës së tyre, komunat në masën më të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Pjesa ekzekutive e raportit nënvizon aspektet e përgjithshme të funksionimit të komunave, duke u fokusuar në kompetencat e kuvendeve të komunave, përkatësisht mbledhjeve të mbajtura, akteve të miratuara, raportit në mes të komunave dhe organit mbikëqyrës, shkallën e respektimit të legjislacionit në fuqi, numrin e shkeljeve ligjore, nivelin e respektimit dhe harmonizimin e veprimeve që rrjedhin nga provizionet ligjore, transparencën si dhe funksionimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe trupave të tjera ndihmëse të kuvendeve të komunave.

Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur gjithsej 112 mbledhje. Prej tyre 89 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 23 të jashtëzakonshme. Në vijim është paraqitur numri i përgjithshëm i mbledhjeve të kuvendeve sipas komunave:

Fig.1 *Mbledhjet e kuvendeve të komunave.*

Paralelisht me kuvendet e komunave janë mbledhur edhe komitetet e përhershme. Edhe pse me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të dy komitetet janë të obligueshme, komunat më pak i kanë kushtuar rëndësi funksionimit të komiteteve për komunitete. Për nga numri i takimeve, Komitetet për Politikë dhe Financa kanë mbajtur gjithsej 96 mbledhje, ndërsa Komitetet për Komunitete kanë mbajtur 62 mbledhje.



Fig.2 *Mbledhjet e komiteteve të përhershme.*

Për dallim nga Komiteti për Politikë dhe Financa i cili ka qenë funksional në të gjitha komunat (me përjashtim të komunës së Zubin Potok dhe Zveçan), Komiteti për Komunitete nuk ka qenë aktiv në komunat: Viti, Kamenicë, Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore dhe Deçan.

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, Kuvendet e Komunave kanë miratuar gjithsej 449 akte komunale, prej të cilave 46 rregullore dhe 403 vendime. Më poshtë është paraqitur figura për numrin e akteve të miratuara sipas komunave:



Fig.3 *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave.*

Këto akte janë pjesë e obligimeve ligjore të komunave dhe kërkohet të jenë në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi. Mirëpo, nisur nga ky aspekt, jo gjithherë komunat u janë përmbajtur rregullave ligjore me rastin e hartimit dhe nxjerrjes së akteve komunale. Gjatë kësaj periudhe, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal janë identifikuar 7 akte të kundërligjshme të cilat janë miratuar në kuvendet e komunave. Prej tyre, 4 akte janë harmonizuar me legjislacionin në fuqi, bazuar në kërkesat për rishqyrtim të ligjshmërisë të dërguara nga MAPL, kurse 3 akte ende nuk janë rishqyrtuar.

Në vijim janë paraqitur rastet e shkeljeve ligjore, duke përfshirë komunat: Rahovec, Suharekë, Gllogoc, Mitrovicë Veriore dhe Kllokot.

Për të gjitha këto raste, MAPL ka dërguar kërkesat për rishqyrtim dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin në fuqi. Komunat të cilat aktet e kundërligjshme nuk i kanë kthyer për rishqyrtim janë: Mitrovica Veriore, Kllokoti dhe Suhareka.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) gjatë periudhës korrik-shtator 2014 ka mbajtur 37 takime të cilat ndërlidhen me çështjet e sigurisë publike për marrjen e masave parandaluese. Në vijim është paraqitur figura për numrin e takimeve të mbajtura të KKSB-ve në komuna:



Fig.4 *Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.*

KOMUNAT: Prishtinë, Vushtrri, Skenderaj, Suharekë, Gllogoc

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, kuvendet e komunave: Prishtinë, Vushtrri, Skenderaj, Suharekës, Gllogoc, kanë mbajtur gjithsej 14 mbledhje. Prej tyre 12 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.5. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Prishtinë, Vushtrri, Skenderaj, Suhareka, Gllogoc.*

Në figurën e mësipërme shihet se kuvendet e komunave Prishtinë dhe Suharekë kanë mbajtur nga tri mbledhje të rregullta, ndërsa kuvendet e komunave Skenderaj, Vushtrri dhe Gllogoc kanë mbajtur nga 2 mbledhje të rregullta. Nga 1 mbledhje të jashtëzakonshme kanë mbajtur kuvendet e komunave Vushtrri dhe Suharekë.

Mbledhjet e kuvendeve të komunave janë mbajtur në pajtim me rregulloret e punës së kuvendeve të komunave. Me përjashtim të komunës së Suharekës dhe Vushtrrisë[1]. Ftesat dhe materialet për mbledhje janë dërguar me kohë dhe në përputhje me nenin 43 të LVL-së. Mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun.

Në takimet e kuvendeve të komunave është vërejtur prezenca e shoqërisë civile, qytetarëve dhe mjeteve të informimit publik. Informimi i qytetarëve për mbledhje është bërë përmes shpalljeve publike dhe faqeve zyrtare elektronike të komunave.

Në shumicën e mbledhjeve të kuvendeve të komunave është vërejtur prezenca e kryetarëve të komunave, e sidomos në rastet kur është kërkuar raportimi para anëtarëve të kuvendit lidhur me situatën ekonomiko-financiare. Kryetarët e komunave gjatë kësaj periudhe kanë raportuar për situatën ekonomiko-financiare, në pajtueshmëri me obligimet ligjore që ka përcaktuar nenin 58 pika (j) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

[1] Lidhur me mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Suharekës të mbajtur më 01.10.2014, MAPL-së nuk i është dërguar ftesa më kohë, si dhe materiali përcjellës. Gjithashtu në këtë komunë janë paraqitur pengesa teknike sa i përket funksionimit të sistemin e teleprezencës. Gjithashtu, Komuna e Vushtrrisë nuk ka dërguar ftesën dhe materialin përcjellës në mënyrë elektronike tek zyrtari përgjegjës i monitorimit në MAPL.

Gjatë periudhës së raportimit, kuvendet e këtyre komunave kanë miratuar vendimet për miratimin e buxhetit për vitin 2015 si dhe projeksionet buxhetore 2015-2017. Gjithashtu në këtë periudhë kanë qenë aktive komitetet e përhershme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme:



Fig.6. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Prishtinë, Vushtrri, Skenderaj, Suhareka, Gllogoc.*

Kuvendi i komunës së Gllogocit ka themeluar edhe komitete tjera siç janë: Komiteti për Shëndetësi, Komiteti për Ambient, Komiteti për Arsim, Komiteti për Ekonomi dhe Komiteti për të Drejtat e Njeriut.

Aktet e miratuara

Komuna e Prishtinës, Vushtrrisë, Skenderajt, Suharekës dhe Gllogocit kanë miratuar gjithsej 44 akte, prej të cilave 7 rregullore dhe 37 vendime. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vlerësuar ligjshmërinë e 16 akteve, ndërsa aktet e tjera janë dërguar për vlerësim në komisionet ndërministrore. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuar nga kuvendet e komunave:



Fig.7. *Aktet e miratuara nga kuvendet e komunave: Prishtinë, Skenderaj, Vushtrri, Suharekë dhe Gllogoc.*

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, shohim së kuvendi i komunës së Skenderajt ka miratuar 13 vendime dhe 3 rregullore, kuvendi i komunës së Gllogocit 10 vendime, kuvendi i komunës së Suharekës 3 vendime dhe 1 rregullore, kuvendi i komunës së Vushtrrisë 6 vendime dhe 1 rregullore, si dhe kuvendi i komunës së Prishtinës 10 vendime dhe 2 rregullore.

Aktet komunale të miratuara rregullojnë fusha të ndryshme nga kompetencat vetanake të komunave, përfshirë: miratimin e buxhetit për vitin 2015, aktet për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ndarjen e subvencioneve, Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme, si dhe akte të tjera për ushtrimin e kompetencave të tyre.

Publikimi i akteve

Komuna e Vushtrrisë ka bërë publikimin e akteve në faqen zyrtare të komunës për periudhën raportuese, mirëpo aktet e publikuara nuk janë të përkthyera në gjuhën serbe.
Komuna e Prishtinës ka bërë publikimin e vendimeve, mirëpo jo edhe të rregulloreve të miratuara. Publikimi i akteve nuk është bërë në gjuhën serbe.
Komuna e Skenderajt ka publikuar të gjitha aktet e miratuara. Publikimi i akteve nuk është bërë në gjuhën serbe.
Komuna e Gllogocit ka bërë publikimin e akteve ne faqen zyrtare, mirëpo, publikimi i akteve të komunës është bërë në linkun e shpalljeve dhe jo në linkun e akteve të komunës, gjithashtu publikimi i akteve nuk është bërë në gjuhën serbe.
Komuna e Suharekës ka publikuar të gjitha aktet e miratuara. Publikimi i akteve nuk është bërë në gjuhën serbe. Publikimi i akteve nuk është bërë në linkun e akteve por në vend tjetër faqen zyrtare të komunës.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi si trup kryesor konsultues i komunës në fushën e sigurisë publike, në bashkëpunim më policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë në të mirë të të gjithë banorëve të komunës. Gjatë periudhës së raportimit është diskutuar lidhur më çështjet që kanë të bëjnë më mirëmbajtjen e rrugëve dhe kanaleve të hapura të qytetit, siguria në shkollat fillore dhe të mesme, vendosja dhe funksionimi i kamerave në shkolla, lëvizja e nxënësve në trotuare, mbajtja e armëve pa leje dhe përdorimi i drogës, krimet ekologjike, parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve, parandalimi i zjarreve në fusha dhe pyje, largimi i lëmosh-kërkuesve nga rruga, siguria e personave me aftësi të kufizuar, parandalimi i kompanive private në gropimin e shtretërve të lumenjve për zhavor, siguria e rinisë në lokalet e natës, bashkëpunimi me EVSB, KLSP dhe OJQ, eliminimi i qenve endacakë, shtimi i kontrollit të sigurisë rreth objekteve fetare etj.
Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës:



Fig.8. *Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës: Prishtinë, Skenderaj, Vushtrri, Suharekë dhe Gllogoc*

Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave

Të gjitha aktet e miratuara nga kuvendet e komunave janë dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës, duke respektuar afatin ligjor për dërgimin e akteve të miratuara nga kuvendi i komunës për shqyrtim të ligjshmërisë.

Shkeljet ligjore

Suharekë,
Rregullorja për transparencën në komunë, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, është konstatuar se është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave, neni 5, paragrafi 1. Deri më tani Kuvendi i Komunës nuk ka ndërmarr asnjë veprim për harmonizimin e këtij akti.

Gllogoc,
Vendimi Nr. 952-39315 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, është konstatuar se është në kundërshtim me Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 9, paragrafi 2. Kuvendi i komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datën 24.09.2014 e ka harmonizuar aktin konform kërkesës së MAPL-së.

Gjetjet më të rëndësishme

Prishtinë

- Mos dërgimi i kompletuar i materialeve në MAPL;
- Mos publikimi i akteve në faqen zyrtare të komunës, konform rregullores për hartimin dhe publikimin e akteve.

Gllogoc

- Mos publikimi i akteve në faqen zyrtare të komunës, konform rregullores për hartimin dhe publikimin e akteve;
- Mos përdorimi i simboleve zyrtare në komunë (emri zyrtar i komunës);
- Themelimi i Komiteteve Konsultative.

Skenderaj

- Takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë në komunës Skenderajt;
- Të mirëmbahet faqja zyrtare e komunës në versionin Serbisht.

Suharekë

- Mos harmonizim i akteve konform shkresës së MAPL-së;
- Mos mirëmbajtja e faqes zyrtare edhe ne versioni serbisht;
- Mos dërgimi i ftesës dhe materialit për mbledhjen e 01.10.2014;
- Mos harmonizimi i rregullores për transparencë në komunë konform shkresë së MAPL-së.

Vushtrri

- Dërgimi i materialeve dhe ftesës për mbledhjet e kuvendit vetëm në formë fizike;
- Mos mirëmbajtja e faqes zyrtare të komunës në versionin serbisht;
- Plotësim-ndryshimi i akteve në kundërshtim me nenin 12 të rregullores për hartimin dhe publikimin e akteve të komunave.

KOMUNAT: Gjakovë, Gjilan, Rahovec

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, kuvendet e komunave: Gjakovë, Gjilan, Rahovec, kanë mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Prej tyre 8 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.9. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Gjakovë, Gjilan, Rahovec.*

Nga figura e mësipërme shohim se kuvendi i komunës së Rahovecit ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, kuvendi i komunës së Gjilanit 3 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, kuvendi i komunës së Gjakovës ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme. Mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun dhe njoftimi për mbledhje është bërë me kohë.

Gjithashtu në këtë periudhë kanë qenë aktive komitetet e përhershme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme:



Fig.10. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Gjakovë, Gjilan, Rahovec.*

Në lidhje me përbërjen e Komiteteve të përhershme, komunat kanë siguruar përfaqësimin e të gjitha subjekteve politike. Duke marrë parasysh se në vitet e mëparshme ka pasur vështirësi në funksionalizimin e Komitetit për komunitete në Komunën e Rahovecit, tani ky komitet është më funksional.

Aktet e miratuara

Kuvendet e komunave: Gjakovë, Rahovec dhe Gjilan, kanë miratuar gjithsej 45 akte, prej të cilave 3 rregullore dhe 42 vendime. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuar nga kuvendet e komunave:



Fig.11. *Aktet e miratuara nga kuvendet e komunave: Gjakovë, Gjilan dhe Rahovec.*

Siç vërejmë nga figura e mësipërme, numrin më të madh të akteve e kanë miratuar Kuvendi i Komunës së Gjilanit dhe Gjakovës me 15 vendime dhe 1 Rregullore, ndërsa Rahoveci me 12 vendime dhe 1 rregullore.

Disa nga aktet e miratuara gjatë kësaj periudhë janë: Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Gjakovës, Plotësim-ndryshimi i Rregullores për ndarjen e Subvencioneve në Gjakovë, Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit , Themelimi i Komitetit për shërbime publike (Gjakovë), miratimi i buxheteve komunale për vitin 2015, vendimet për hartimin e Planeve Rregulluese, Vendime për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës (Gjakovë), Plotësim-Ndryshimi i Statutit të Komunës së Rahovecit si dhe akte të tjera që mbulojnë fusha të ndryshme të kompetencave komunale.

Disa nga aktet e miratuara nga kuvendet e komunave e Komunave Gjilan dhe Rahovec nuk janë publikuar në faqet zyrtare. Komuna e Rahovecit ka publikuar vetëm 2 vendime dhe 1 rregullore, kurse Komuna e Gjilanit vetëm 5 vendime. Komuna e Gjakovës ka qenë efikase në publikimin e akteve komunale. Kjo komunë ka publikuar të gjitha aktet e miratuara në këtë periudhë, si dhe aktet e miratuara në periudhën

paraprake. Këto komuna nuk kanë publikuar në faqen zyrtare të komunës aktet në gjuhët zyrtare.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Sipas të dhënave, gjatë periudhës raportuese komuna e Gjakovë dhe Gjilanit kanë mbajtur takimet e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi. Për dallim nga to, Komuna e Rahovecit nuk ka mbajtur asnjë takim të Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës:



Fig.12. *Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi: Gjakovë, Gjilan, Rahovec.*

Nga figura më lart, shohim se në komunën e Rahovecit, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka mbajtur asnjë takim. Megjithatë KKSB në komunën e Rahovecit në periudhën janar-qershor ka mbajtur 3 takime dhe sipas kësaj qëndron më mirë se KKSB e Komunës së Gjakovës e cila deri tani (shtuar një takimi të mbajtur në periudhën janar-qershor 2014) ka mbajtur vetëm 2 takime.

Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave

Të gjitha aktet e miratuara nga kuvendet e komunave janë dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës. Të gjitha komunat kanë respektuar afatin ligjor për dërgimin e akteve të miratuara nga kuvendi i komunës për shqyrtim të ligjshmërisë. Megjithatë, ndryshe nga dy komunat e tjera, komuna e Gjilanit ka respektuar me rregull nenin 80.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ku përveç listës së akteve të komunës, ka dërguar të gjitha aktet e miratuara nga kryetari i komunës.

Shkeljet ligjore

Gjatë kësaj periudhë janë evidentuar këto raste të shkeljeve ligjore dhe procedurale me rastin e nxjerrjes së akteve nga kuvendet e komunave, me sa vijon:

Rahovec

- Vendimi 01 Nr. 76/2014 i miratuar nga kuvendi i komunës së Rahovecit për shpalljen e interesit të veçantë publik dhe kthimin e një pjese të pronës nga NBI "Rahoveci" në emër të Komunës është në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. *Pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është rishqyrtuar, dhe është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*
- Vendimi 01 Nr. 78/2014 i miratuar nga kuvendi i komunës së Rahovecit për shpalljen e interesit të veçantë publik dhe bartjen e të drejtës së pronësisë të ngastrave nr. 1195-1; 1195-2 dhe 1105-3 nga NSH "Podrimja" në emër të Komunës së Rahovecit është në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. *Pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është rishqyrtuar, dhe është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*
- Vendimi 01. nr. 2292 Dt. 30.05.2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Rahovecit, sipas vlerësimit të MAPL-së, ka qenë në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores Nr. 01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. *Pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është rishqyrtuar, dhe është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*

Gjakovë

- Vendimi 01 Nr. 011-17920 i miratuar nga kuvendi i komunës së Gjakovës shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jobujqësore, të parcelës nr. 158/k me sipërfaqe 0.21.11 ha, ZK Gjakovë, Komisioni përkatës ndërministror e ka vlerësuar se Vendimi i lartë përmendur është i kundërligjshëm, sepse prek sistemin e ujitjes së tokave bujqësore. *Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2014, kuvendi i komunës Gjakovë e ka rishqyrtuar këtë vendim, mirëpo ka rikonfirmuar vendimin e mëparshëm, me arsyetimin se konstatimet e komisionit ndërministror nuk qëndrojnë.*

Gjetjet më të rëndësishme

Gjilan

- Komuna e Gjilanit ende nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të qëndrueshëm të publikimit të akteve në faqet zyrtare të komunës.

Rahovec

- Komuna e Rahovecit ende nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të qëndrueshëm të publikimit të akteve në faqet zyrtare të komunës.

- Në Komunën e Rahovecit ende nuk është funksionalizuar Këshilli për Hoqën e Madhe ashtu siç parashihet me Ligjin Nr. 04/L-062 për Fshatin Hoçë e Madhe.

Gjakovë

- Në komunën e Gjakovës është evidentuar një rast i shkeljes ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës. Edhe pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga Komisioni ndërministrore, komuna nuk ka bërë rishqyrtimin sipas referencave të këtij komisioni.
- KKSB në komunën e Gjakovës nuk është mbledhur sipas rregullave të Udhëzimit Administrativ për KKSB. Numri i mbledhjeve të këtij mekanizmi të sigurisë është shumë i ulët.

KOMUNAT: Pejë, Istog, Klinë, Malishevë, Lipjan

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, kuvendet e komunave: Pejë, Klinë, Istog, Lipjan dhe Malishevë kanë mbajtur gjithsej 15 mbledhje. Prej tyre 12 mbledhje kanë qenë të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.13. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Pejë, Klinë, Istog, Lipjan, Malishevë.*

Nga figura e mësipërme shihet që kuvendet e komunave të Istogut dhe Malishevës kanë mbajtur nga 3 mbledhje të rregullta, ndërsa kuvendet e komunave të Klinës, Lipjanit dhe e Pejës nga dy mbledhje të rregullta. Nga 1 mbledhje të jashtëzakonshme kanë mbajtur kuvendet e komunave të Klinës, Lipjanit dhe Malishevës.

Mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun, përveç mbledhjes së jashtëzakonshme të kuvendit të komunës së Malishevës e thirrur për datën 11.09.2014, e cila për arsye të përjashtimit të publikut është ndërprerë dhe e njëjta është vazhduar me datën 29.09.2014 me pjesëmarrje të publikut. Informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendeve është bërë përmes faqeve zyrtare të komunave, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik.

Gjatë kësaj periudhe janë shënuar dy raste të bojkotimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme. Një rast është shënuar në kuvendin e komunës së Malishevës, ku për arsye të përjashtimit të publikut opozita ka lëshuar mbledhjen, ndërsa rasti tjetër ka ndodhur në kuvendin e komunës së Lipjanit për arsye të thirrjes me vonesë të mbledhjes dhe ndërrimit të rendit të ditës.

Sa u përket komiteteve të përhershme (Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete), këto komitete kanë qenë funksionale. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të këtyre komiteteve është 27, prej të cilave 16 mbledhje janë mbajtur nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe 11 mbledhje nga Komiteti për Komunitete.

Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme:



Fig.14. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Pejë, Klinë, Istog, Lipjan, Malishevë.*

Siç shihet nga figura më lartë, numrin më të madh të mbledhjeve gjatë periudhës së raportimit e ka mbajtur Komiteti për Politikë e Financa në komunën e Istogut me 6 mbledhje, Komiteti për Politikë e Financa në komunën e Lipjanit dhe të Malishevës kanë mbajtur nga 3 mbledhje, ndërsa Komiteti për Politikë e Financa në komunën e Pejës dhe Klinës kanë mbajtur nga 2 mbledhje. Edhe Komiteti për Komunitete ka qenë funksional në periudhën korrik-shtator. Ky komitet ka mbajtur nga tri mbledhje në komunën e Malishevës dhe të Klinës, nga dy mbledhje në komunën e Pejës dhe Istogut, ndërsa një mbledhje në Komunën e Lipjanit.

Përveç Komiteteve të përhershme në disa komuna janë themeluar edhe komitete tjera dhe komitete konsultative.

Komuna e Lipjanit ka themeluar Komitetin për Shërbime Publike ndërsa ajo e Malishevës ka themeluar Komitetin konsultativ për persona me aftësi të kufizuara dhe hartimin e planeve lokale të veprimit.

Edhe Komuna e Klinës ka themeluar 2 Komitete Konsultative: Komiteti për Çështje Emergjente dhe Komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në periudhën korrik-shtator kuvendet e komunave kanë formuar komisione të ndryshme varësisht prej nevojave të tyre në fusha të caktuara. Kuvendi i komunës së Malishevës ka formuar Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, Komisionin për caktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, Komisionin për emërtimin e rrugëve. Kuvendi i komunës së Pejës ka formuar Komisionin për udhëheqjen dhe koordinimin të punës në terren për zgjedhjen e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës, Komisionin për punë komunale dhe shërbime publike.

Kuvendi i komunës së Istogut ka ndryshuar Statutin e komunës, me këtë rast Staradrani është shpallur zonë urbane.

Miratimi i akteve

Kuvendet e komunave kanë miratuar një numër të akteve nënligjore, si rregullore dhe vendime. Nga pikëpamja kuantitative, kuvendet e komunave kanë miratuar 66 akte nënligjore, prej të cilave 4 rregullore dhe 62 vendime. Nga këto akte të miratuara 19 janë konfirmuar të ligjshme dhe 9 akte të tjera janë përcjellë në Komisione Ndërministrore për vlerësim të ligjshmërisë.[2] Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuara:



Fig.15. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Pejë, Klinë, Istog, Lipjan, Malishevë.*

Një obligim tjetër ligjor i komunave është edhe publikimi i akteve të miratuara në faqet zyrtare të komunës. Komuna e Istogut dhe e Lipjanit nuk i kanë të publikuara aktet e miratuara, komuna e Klinës i ka të publikuara vetëm aktet e miratuara në muajin gusht në të dy gjuhët, komuna e Malishevës i ka të publikuara aktet e miratuara në muajin korrik dhe gusht por vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa komuna e Pejës aktet e miratuara në muajit korrik dhe shtator i ka të publikuara pjesërisht.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Në këto komuna në periudhën e raportimit kanë funksionuar edhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Çështje të rëndësishme të cilat janë diskutuar në takimet e këtyre këshillave kanë qenë: çështja e sigurisë në këto Komuna për të cilën çështje kanë raportuar Komandantët e Stacionit Policor, dhe se gjatë periudhës së raportimit gjendja në këto komuna është raportuar se është stabile, me përjashtim të rasteve që kanë ndodhur në brezin kufitar në komunën e Istogut lidhur me pyjet. Një tjetër çështje që është diskutuar në takimet e KKSB-së ka qenë edhe çështja e vjedhjeve dhe e plaçkitjeve të qytetarëve.

[2] Aktet e miratuara në fund të muajit shtator nuk janë përfshirë në listën e akteve të vlerësuara.

Po ashtu është diskutuar për rritjen e kontrollit ne trafik, rritjen e sigurisë në shkolla, ashpërsimin e masave ndaj ngasësve të automjeteve, asistimet e policisë në të gjitha veprimet e inspektoratit komunal në ushtrimin e detyrave të tyre, çështja e qenve endacak etj.

Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës:



Fig.16. *Takimet Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës: Pejë, Klinë, Istog, Lipjan, Malishevë*

Gjetjet më të rëndësishme

Malishevë

- Në komunën e Malishevës mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës e thirrur për datën 11.09.2014 është ndërprerë për arsye të përjashtimit të publikut dhe e njëjta është vazhduar me datën 29.09.2014.
- Komunat nuk i ka publikuar të gjitha aktet e miratuara në këtë periudhë të raportimit.

Lipjan

- Në komunën e Lipjanit ka ndodhur një bojkotim i mbledhjes së kuvendit nga opozita e kësaj komunë, kjo pasi që, mbledhja e jashtëzakonshme e thirrur në muajin shtator nuk ishte thirrur sipas afateve të parapara ligjore, dhe se është ndryshuar rendi i ditës i paraparë për atë mbledhje të jashtëzakonshme.
- Komunat nuk i kanë publikuar të gjitha aktet e miratuara në këtë periudhë të raportimit.

Pejë

- Në komunë e Pejës sistemi i teleprezencës nuk ka qenë funksional, dhe është pamundësuar monitorimi i mbledhjeve të kuvendit të komunës.

KOMUNAT: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Shtime

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, komunat: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë dhe Shtime kanë mbajtur gjithsej 18 mbledhje, prej të cilave 15 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.17. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë, Shtime.*

Nga figura e mësipërme shihet që kuvendet e komunave të Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë dhe Shtime kanë mbajtur nga 3 mbledhje të rregullta, ndërsa kuvendet e komunave Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë dhe Shtime kanë mbajtur nga 1 mbledhje të jashtëzakonshme.

Sa u përket komiteteve të përhershme, në përgjithësi këto komitete kanë mbajtur 27 mbledhje. Nga këto 16 i ka mbajtur Komiteti për Politikë dhe Financa ndërsa 11 i ka mbajtur Komiteti për Komunitete. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme:



Fig.18. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë, Shtime.*

Siç shihet nga figura më lartë Komiteti për Politikë dhe Financa në komunën e Fushë Kosovës ka mbajtur 4 mbledhje, ndërsa në komunat Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik dhe Shtime kanë mbajtur nga 3 mbledhje. Ndërsa Komiteti për Komunitete në komunën e Fushë Kosovës dhe Shtimes ku ka mbajtur nga 3 mbledhje, në komunën e Ferizajt dhe Mitrovicës Jugore ky komitet ka mbajtur nga 2 mbledhje, ndërsa vetëm një mbledhje ka mbajtur në komunën e Kaçanikut.

Përveç Komiteteve të përhershme komuna e Mitrovicës Jugore ka themeluar edhe 5 komitetet konsultative siç janë: Komitetin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komitetin për kulturë rini dhe sport, Komitetin konsultativ për persona me aftësi te kufizuara, Komitetin konsultativ për shërbime publike dhe zhvillim ekonomik, Komitetin konsultativ për planifikim urban dhe mbrojtje të ambientit.

Mbledhjet e kuvendeve kanë qenë transparente, ftesat dhe materialet për mbledhjet e kuvendit janë dërguar nga të gjitha komunat në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Përveç kësaj, komunat obligohen të dërgojnë materialet përcjellëse që janë në rend të ditës për diskutim në mbledhjet e kuvendeve. Komuna e Fushë Kosovës në dy raste ka dërguar vetëm ftesën për mbledhje por jo edhe materialet që janë shqyrtuar në mbledhje.

Miratimi i akteve

Ndër çështjet kryesore që kuvendet e këtyre komunave i kanë kushtuar rëndësi gjatë kësaj periudhe, ishte miratimi propozim-buxhetit të komunave për vitin 2015, si dhe kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017. Procesit të miratimit të propozim-buxhetit të komunave i kanë paraprirë diskutimet publike me qytetarë konform udhëzimeve dhe qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuara nga kuvendet e komunave:



Fig.19. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë, Shtime.*

Nga figura e mësipërme shihet se në përgjithësi këto komuna kanë miratuar 92 akte, nga të cilat: 7 rregullore dhe 85 vendime. Kuvendi i komunës së Ferizajt ka miratuar 26 vendime dhe 1 rregullore, kuvendi i komunës së Mitrovicës Jugore ka miratuar 25 vendime dhe 3 rregullore, kuvendi i komunës së Fushë-Kosovës 9 vendime dhe 1 rregullore, kuvendi i komunës së Kaçanikut 9 vendime dhe 1 rregullore, si dhe kuvendi i komunës së Shtimes 16 vendime dhe 1 rregullore.

Lidhur me përgjegjësitë e komunave për informim të drejtë të qytetarëve lidhur me aktivitetet e kuvendeve të komunave, në adresën zyrtare të komunave janë postuar informacione të përgjithshme kryesisht lidhur me aktivitetet e kryetarëve të komunave.

Komuna e Ferizajt dhe Mitrovicës Jugore i ka publikuar aktet e miratuara në muajin korrik dhe gusht në gjuhen shqipe dhe serbe, ndërsa komuna e Kaçanikut, Shtimes dhe Fushë Kosovës ka publikuar aktet vetëm në gjuhën shqipe për muajt korrik dhe gusht. Aktet e muajit shtator nuk janë publikuar pasi presin konfirmimet nga organi mbikëqyrës ashtu siç e parasheh Rregullorja Nr. 01/2013 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave.

Sa i përket krijimit të kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organet mbikëqyrëse si formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese, dërgimi i akteve komunale ka qenë i rregullt. Në këtë periudhë nga gjithsej 92 akte të miratuara në kuvendet e komunave, 41 akte janë vlerësuar nga MAPL, ndërsa 51 të tjera janë dërguar në ministritë e linjës për vlerësim të ligjshmërisë.

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Sipas të dhënave, gjatë periudhës raportuese në komunat: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë, Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, ka qen funksional duke mbajtur takime te vazhdueshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës:



Fig.20. *Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi: Ferizaj, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Fushë Kosovë, Shtime.*

Çështje të rëndësishme të cilat janë diskutuar në takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkës kanë qenë të ndërlidhura më sigurinë publike në këto komuna, për të cilat kanë raportuar Komandantët e Stacionit Policor, dhe në përgjithësi gjendja e sigurisë është konsideruar e qetë dhe stabile. KKSB në Komunën e Ferizajt ka trajtuar çështjet për masat te cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen e pyjeve, vendosjen e kamerave nëpër shkolla dhe vendet më të frekuentuara të qytetit. Po ashtu është kërkuar që të respektohet plotësisht ligji kundër pirjes se duhanit e sidomos në shkolla.

Në komunën e Kaçanikut është diskutuar për prerjet e pyjeve dhe masave për parandalimin e kësaj dukurie. Në komunën e Mitrovicës Jugore është diskutuar rreth gjendjes së krijuar më rastin e vendosjes së parkut të paqes mbi urën e lumit "Ibër" dhe nga ky takim ka dalë konkluzioni që të ndërmerren masat e duhura për sigurinë e qytetarëve dhe gjendjes në përgjithësi. Në komunën e Fushë-Kosovës, është diskutuar për numrin e madh të qenve endacak.

Gjetjet më të rëndësishme

- Komunat nuk i kanë publikuar të gjitha aktet e miratuara në këtë periudhë të raportimit. Disa komuna nuk i kanë të publikuar aktet në të dy gjuhët zyrtare.
- Komuna e Fushë Kosovës nuk ka dërguar materialet përcjellëse së bashku me ftesën për mbledhje të kuvendit të komunës.
- Komuna e Ferizajt ende nuk e ka rishqyrtuar Vendimin për themelimin e ndërmarrjes publike komunale, i cili është konstatuar i kundërligjshëm nga organi mbikëqyrës.

KOMUNAT: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Shtërpce, Kllokot

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, komunat: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Shtërpcë Kllokot kanë mbajtur gjithsej 13 mbledhje, prej të cilave 11 të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.21. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Shtërpcë Kllokot.*

Siç shihet nga figura më lartë, kuvendi i komunës së Kllokotit ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, kuvendet e komunave së Graçanicës dhe Ranillugut kanë mbajtur nga 2 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme, kuvendet e komunave së Parteshit dhe Shtërpcës kanë mbajtur nga 2 mbledhje të rregullta.

Komitetet e përhershme

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë mbajtur gjithsej 23 mbledhje. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajt 13 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitete 10 mbledhje, si shihet edhe në figurën më poshtë:



Fig. 22. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Shtërpcë.*

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat janë të obliguara që në komitetet për komunitete të përfshijnë të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në territorin e komunës, derisa kur bëhet fjalë për komitetin për politika dhe financa është e nevojshme të përfshihen të gjitha subjektet politike.

Në komunën e Parteshit, përveç tri komiteteve të obligueshme, janë formuar edhe tri komitete tjera, të cilat janë: Komiteti për komunitete, kthim dhe riintegrim, Komiteti për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale dhe Komiteti për shërbime publike.

Miratimi i akteve

Në periudhën korrik-shtator të vitit 2014, kuvendet e komunave kanë miratuar akte të rëndësishme për ushtrimin e kompetencave të tyre. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuara nga kuvendet e komunave:



Fig.23. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Graçanicë, Ranillug, Partesh, Kllokot, Shtërpcë.*

Nga figura më lartë shihet se kuvendi i komunës së Graçanicës ka miratuar 15 vendime dhe 1 rregullore, kuvendi i komunës së Ranillugut ka miratuar 13 vendime dhe 1 rregullore, kuvendi i komunës së Parteshit ka miratuar 7 vendime, kuvendi i komunës së Kllokotit ka miratuar 10 vendime dhe kuvendi i komunës së Shtërpcës ka miratuar 6 vendime. Të gjitha aktet e miratuara janë dërguar në organin mbikëqyrës për shqyrtim të ligjshmërisë. Aktet e miratuara nga kuvendet e komunave janë të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të komunës.

Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave

Të gjitha aktet e miratuara nga kuvendet e komunave janë dërguar për vlerësim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës. Të gjitha komunat kanë respektuar afatin ligjor për dërgimin e akteve të miratuara nga kuvendi i komunës për shqyrtim të ligjshmërisë.

Shkeljet ligjore

Gjatë kësaj periudhë janë evidentuar këto raste të shkeljeve ligjore dhe procedurale me rastin e nxjerrjes së akteve nga kuvendet e komunave, me sa vijon:

Partesh
Vendimi i kuvendit të komunës së Parteshit Nr.79/2014 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nga organi mbikëqyrës është konstatuar se vendimi nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB-a dhe 03/2012 MAPL për formimin dhe funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. *Pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është rishqyrtuar, dhe është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*

Graçanicë
Vendimi i kuvendit të Komunës së Graçanicës Nr.Gb-305 për rishqyrtimin e vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nga organi mbikëqyrës është konstatuar se vendimi nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB-a dhe 03/2012 MAPL për formimin dhe funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. *Pas kërkesës për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është rishqyrtuar, dhe është harmonizuar me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*

Kllokot
Vendimi i kuvendit të komunës së Kllokotit Nr.5057/2 mbi pagesën e mëditjeve për anëtarët e kuvendit të komunës të cilët kanë munguar në mbledhjen e kuvendit të komunës. K*y vendim nuk është harmonizuar ende me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së.*

KOMUNAT: Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014 kuvendet e komunave: Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore, kanë mbajtur gjithsej 10 mbledhje. Prej tyre 8 kanë qenë të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.24. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore.*

Siç shihet nga figura më lartë, kuvendi i komunës së Mitrovicës Veriore ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta, kuvendi i komunës së Novobërdës ka mbajtur 2 mbledhje të rregullta ndërsa kuvendet e komunave Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kanë mbajtur nga 1 mbledhje të rregullta. Poashtu, kuvendi i komunës së Zubin Potokut ka mbajtur edhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.
Mbledhjet kanë qenë transparente dhe të hapura për publikun, ftesat për mbledhjet e kuvendit janë dërguar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo nuk janë dërguar edhe materialet për rendin e ditës qe ka qen për diskutim ne këto mbledhje.

Në komunat**:** Novobërdë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore, gjatë kësaj periudhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka qenë funksional duke mbajtur 6 mbledhje, ndërsa Komiteti për Komunitetet nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të komiteteve të përhershme:



Fig.25. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore.*

Siç shihet nga figura më lartë, Komiteti për Politikë dhe Financa në Mitrovicën Veriore ka mbajtur 3 mbledhje, në komunë e Novobërdës ka mbajtur 2 mbledhje ndërsa në komunën Leposaviq ka mbajtur 3 mbledhje, në komunën e Zubin Potokut ka mbajtur 2 mbledhje. Ndërsa Komiteti për Komunitetet në komunën e Leposaviqit ka mbajtur 1 mbledhje, në komunën e 2 mbledhje.

Miratimi i akteve

Në periudhën korrik-shtator 2014, komunat kanë nxjerr 27 akteve juridike nënligjore. Nga këto akte janë miratuar 4 rregullore dhe 23 vendime.



Fig.26. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Novobërdë, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore*

Nga figura më lartë shihet se kuvendi i komunës së Novobërdës ka miratuar 15 vendime dhe 2 rregullore, kuvendi i komunës së Zveçanit ka miratuar 5 vendime, kuvendi i komunës së Mitrovicës Veriore ka miratuar 2 vendime dhe 1 rregullore,

kuvendi i komunës së Zubin Potokut ka miratuar 2 vendime dhe kuvendi i komunës së Leposaviqit ka miratuar 1 vendim dhe 1 rregullore.
Të gjitha aktet e miratuara janë dërguar në organin mbikëqyrës për shqyrtim të ligjshmërisë. Aktet e miratuara nga kuvendet e komunave nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës, pasi faqet zyrtare nuk janë funksionale.

Gjatë kësaj periudhe korrik–shtator janë miratuar 27 akte për komunat: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë vlerësimin e 18 akteve të këtyre komunave ndërsa në Komisionet Ndërministrore janë dërguar për vlerësim 9 akte. Në këto komuna nuk është bërë publikimi i akteve në faqen zyrtare të komunave.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi përveç në komunën e Novobërdës, në komunat e tjera nuk është themeluar. KKSB në komunën e Novobërdës gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 1 mbledhje.

Shkeljet ligjore

Mitrovicë Veriore
Në komunën e Mitrovicës Veriore, është konstatuar një shkelje ligjore. Akti në fjalë ka të bëjë me plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës i cili është bërë me Vendim. Akti nuk është rishqyrtuar nga kuvendi i komunës së Mitrovicës Veriore edhe pas dërgimit të shkresës ligjore nga organi mbikëqyrës MAPL-ja.

Leposaviqi
Në komunën e Leposaviqit, është konstatuar një shkelje ligjore. Akti në fjalë ka të bëjë me Rregulloren e Punës së kuvendit të komunës. Pas dërgimit të shkresës për rishqyrtim të katit komuna e Leposaviqit e ka harmonizuar atë sipas rekomandimeve të MAPL-së.

KOMUNAT: Hani i Elezit, Dregash, Viti, Podujevë, Kamenicë

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, kuvendet e komunave: Hani i Elezit, Dragash, Podujevë, Viti dhe Kamenicë kanë mbajtur gjithsej 18 mbledhje. Prej tyre 14 kanë qenë të rregullta dhe 4 mbledhje të jashtëzakonshme. Ndërsa nëse i pasqyrojmë ndaras, numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave qëndron si në vijim:



Fig.27. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Hani i Elezit, Dragash, Podujevë, Viti, Kamenicë.*

Nga figura e mësipërme shihet që kuvendi i komunës së Podujevës, Vitisë dhe Kamenicës kanë mbajtur nga 4 mbledhje, kuvendi i komunës së Dragashit dhe Hanit të Elezit kanë mbajtur nga 3 mbledhje. Kurse nga të dhënat e mësipërme vërejmë se në këtë periudhë janë mbajtur 4 mbledhje e jashtëzakonshme.

Lidhur me mbarëvajtjen e punës së kuvendeve, të gjitha mbledhjet e kuvendeve kanë qenë të hapura për publikun. Informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendeve është bërë përmes faqeve zyrtare të komunave, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik.

Sa u përket komiteteve të përhershme, këto komitete kanë qenë funksionale. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të këtyre komiteteve është gjithsej 20, prej të cilave 15 i ka mbajtur Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 5 Komitetit për Komunitete. Në vijim janë pasqyruar të dhënat për mbledhjet e Komiteteve të Përhershme për secilën komunë:



Fig.28. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Hani i Elezit, Dragash, Podujevë, Viti, Kamenicë.*

Miratimi i akteve

Krahas asaj që u pasqyrua më lartë, në kuvendet e komunave janë miratuar një numër i akteve juridike nënligjore, përfshirë rregullore, vendime, plane të ndryshme. Nga pikëpamja kuantitative, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 58 akte nënligjore, prej të cilave 8 rregullore dhe 50 vendime. Më poshtë është paraqitur numri i akteve për secilën komunë:



Fig.29. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Hani i Elezit, Dragash, Podujevë, Viti, Kamenicë.*

Nga figura e mësipërme shihet që në miratimin akteve më efikase është treguar kuvendi i komunës së Kamenicës dhe Podujevës, ndërkaq më pak efikase kuvendi i komunës së Hanit të Elezit dhe Vitisë. Materia që rregullojnë aktet e nxjerra në këtë periudhë i përket fushës së mjedisit, akteve të natyrës financiare, miratimi i projekt-buxhetit, akte të karakterit organizativ dhe funksional të komunës, themelimin e komisioneve për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, dhënien në shfrytëzim të pronës komunale etj.

Gjatë kësaj periudhe korrik–shtator janë miratuar 58 akte për komunat: Hani i Elezit, Dragashi, Podujeva, Vitia dhe Kamenica. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë vlerësimin e 30 akte të këtyre komunave ndërsa në Komisionet Ndërministrore janë dërguar për vlerësim 28 akte.

Në këto komuna bëhet edhe publikimi i akteve në faqen zyrtare të komunave përkatëse nga gjithsejtë 58 akte sa janë 24 janë të publikuara. Komuna e Dragashit i ka publikuara 6 akte, Kamenica 4 akte, Vitia 2 akte, Podujeva 10 akte dhe Hani i Elezit i ka publikuar 2 akte në faqen zyrtare të komunës.

Lidhur me përgjegjësitë e komunave për informim të drejtë të qytetarëve lidhur me aktivitetet e kuvendeve të komunave, në adresën zyrtare të komunave janë postuar informacione të përgjithshme kryesisht lidhur me aktivitetet e kryetarëve të komunave. Mirëpo, edhe gjatë kësaj periudhe nuk është vërejtur ndonjë progres i komunave në publikimin e akteve të nxjerra nga kryetari dhe kuvendi i komunës me qëllim të informimit të qytetarëve. Përjashtim në këtë mes bënë vetëm Komuna e Hanit të Elezit, e cila ka publikuar të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi i Komunës. Komunat e tjera, vetëm pjesërisht e kanë bërë publikimin e akteve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës.

Gjatë kësaj periudhe, informimi dhe komunikimi me organin mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt në të gjitha rastet. Megjithëse në shumicën e rasteve ftesa për mbledhjet e kuvendit është dërguar me kohë, kjo nuk ka ndodhur edhe për materialet e mbledhjeve të kuvendit të komunës së Dragashit. Në shumë raste komunat nuk i kanë dërguar paraprakisht materialet e mbledhjeve të kuvendit tek zyrtarët monitorues të MAPL-së, edhe pse kjo është obligim ligjorë i komunave. Po ashtu, edhe sistemit të teleprezencës, ka funksionuar mirë.

Sa i përket krijimit të kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organet mbikëqyrëse si formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese, dërgimi i akteve komunale ka qenë i rregullt. Tashmë komunat: Hani i Elezit, Podujeva, Dragashi, Kamenica dhe Vitia, kanë treguar praktikë të mirë në dërgimin e akteve komunale duke përfshirë edhe shfrytëzimin e mundësisë së konsultimit paraprak, para nxjerrjes së akteve juridike komunale. Megjithatë, në këtë periudhë është konstatuar vetëm një shkelje procedurale në komunën e Kamenicës kur me Vendim është bërë vazhdimi i vlefshmërisë të Rregullores për Tatimin në Pronë Nr. 01/19248 të datës 26.09.2014, për vitin 2015,gjë që është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, përkatësisht me nenin 12, i cili e precizon qartë se amandamentimi, plotësimi ose shfuqizimi i një akti nënligjor të komunës bëhet nga akti i njëjtë nënligjor.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Aspekt tjetër i rëndësishëm për t'i përmbledhur në këtë pjesë të raportit është edhe puna e mekanizmave konsultativ në fushën e sigurisë. Mekanizëm i tillë siç dihet është edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili themelohet në kuvendin e komunës ndërsa kryesohet nga kryetari i komunës, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB. Sipas të dhënave, në këto komuna KKSB ka zhvilluar numrin e mëposhtëm të takimeve:



Fig. 30. *Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi: Hani i Elezit, Dragash, Podujeva, Vitia dhe Kamenica.*

Nga figura e mësipërme vërejmë se KKSB ka mbajtur takime në Komunën e Hanit të Elezit, Podujevës, Dragashit, Kamenicës dhe Vitisë.

Zakonisht në takimet e KKSB-së rëndësi të veçantë ju kushtohet sigurisë në komuna një vlerësim i përgjithshëm i gjendjes aktuale. Për gjendjen e Sigurisë kryesisht raportojnë Komandantët e Stacionit Policor, të cilët në përgjithësi gjendjen e sigurisë e kanë konsideruar si të qetë.

Por ka edhe shumë çështje tjera të cilat diskutohen e që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me jetën e qytetarëve të komunës përkatëse siç janë: çështja e taksistëve ilegal të cilët veprojnë në komuna, manifestimet e ndryshme të cilat i ka komuna si dhe aktivitetet e ndryshme të cilat janë në komunë, fokus të veçanet i kushtohet nëse eventualisht ndodhë ndonjë fatkeqësi natyrore, edhe shumë çështje të tjera që e brengosen jetën e një qytetari të rëndomtë.

Çështje të rëndësishme të cilat janë diskutuar në takimet e këtyre këshillave kanë qenë edhe për masat te cilat duhet të ndërmerren për prerjen e pyjeve si dhe për vendosjen e kamerave nëpër shkolla. Po ashtu është kërkuar që të respektohet plotësisht ligji kundër pirjes se duhanit e sidomos në shkolla.

Shqetësim tjetër ka qenë edhe për numrin e madh të qenve endacak dhe mundësia e largimit të tyre për shkak se shumë raste ka pasur edhe kur janë treguar të rrezikshëm për fëmijët.

Gjithashtu rëndësi të veçanet në komunën e Hanit të Elezit ju ka kushtuar edhe arrestimit të disa personave dhe pjesëmarrja në Siri. Kryetari Rufki Suma i shprehi brengat e veta duke e cilësuar si problem kombëtar por edhe problem që e ballafaqon komunën e Hanit të Elezit për shkak se numri ma i madh i të arrestuarve është nga komuna e Hanit të Elezit.

Shkeljet ligjore

Kamenicë
Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Rregullores për Tatimin në Pronë Nr. 01/19248 të datës 26.09.2014, për vitin 2015, organi mbikqyrës ka konstatuar së ky vendim është në kundërshtim më Rregulloren Nr. 01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, përkatësisht me nenin 12. K*y vendim nuk është harmonizuar ende me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së MAPL-së, por është brenda afatit të përcaktuar ligjor.*

Të gjeturat kryesore

- Publikimi i akteve të organeve të komunës nuk bëhet sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Rregulloren Nr.01/2013 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Të dërgohen në MAPL, procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), sipas dispozitave ligjore të përcaktuara më Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012MPB–03/2013 MAPL për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Aktet e miratuar nga organet e komunës të publikohen në faqen zyrtare të komunës;
- Të regjistrohen dhe të publikohen në faqen zyrtare të komunës pronat e paluajtshme të komunës që janë të dedikuara për dhënien në shfrytëzim.

KOMUNAT: Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Obiliq

Gjatë periudhës korrik-shtator 2014, komunat: Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Obiliq, kanë mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej të cilave 9 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i mbledhjeve të kuvendeve të komunave:



Fig.31. *Mbledhjet e kuvendeve të komunave: Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Obiliq.*

Siç shihet nga tabela e mësipërme kuvendet e komunave: Prizren, Obiliq, Junik, dhe Mamushë kanë mbajtur nga dy (2) mbledhje të rregullta. Kuvendi i Komunës së Deçanit ka mbajtur një (1) mbledhje të rregullta. Ndërsa, sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme kuvendet e komunave të Prizrenit, Obiliqit dhe Mamushës kanë mbajtur nga një (1) mbledhje të jashtëzakonshme.

Informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendeve është bërë përmes faqeve zyrtare të komunave, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik.

Lidhur me mbarëvajtjen e mbledhjeve vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe te gjitha mbledhjet janë zhvilluar konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Mbledhjet e Komiteteve të Përhershme

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitet si komitete të Përhershme, kanë qenë funksionale gjatë kësaj periudhe, duke mbajtur mbledhje të vazhdueshme. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të këtyre komiteteve është 18. Prej tyre njëmbëdhjetë (11) i ka mbajtur Komitetit për Politikë dhe Financa dhe shtatë (7) Komitetit për Komunitete. Në vijim për mes figurës kemi pasqyruar numrin e mbledhjeve të komiteteve të përhershme në këto komuna:



Fig.32. *Mbledhjet e komiteteve të përhershme: Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Obiliq.*

Përveç komiteteve të përhershme neni 51.2, i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, përcakton se kuvendi i komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Kuvendi i komunës së Junikut ka themeluar Komitetit për Shërbime Publike, ndërsa komunat tjera nuk kanë themeluar asnjë komitet të tillë. Gjithashtu kuvendet e komunave kanë të drejt të themelojnë edhe komitete konsultative, por deri me tani nuk i kanë të themeluar asnjë nga këto komitet.

Aktet e miratuara

Kuvendet e komunave gjatë kësaj periudhe kanë miratuar në total 61 akte nënligjore. Nga këto akte, 11 janë Rregullore, 48 janë Vendime, 1 planë për menaxhimin e mbeturinave dhe 1 planë rregullues urbanë. Më poshtë është paraqitur numri i akteve për secilën komunë. Në vijim përmes figurës është paraqitur numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave:



Fig.33. *Aktet e miratuar nga kuvendet e komunave: Prizren, Mamushë, Deçan, Junik, Obiliq.*

Nga tabela e më sipërme shihet se kuvendi i komunës së Prizrenit ka miratuar 1 Rregullore dhe 16 Vendime, kuvendi i komunës së Deçanit ka miratuar 2 Rregullore dhe 4 Vendime, kuvendi i komunës së Obiliq ka miratuar 3 rregullore dhe 16 Vendime, kuvendi i komunës së Junik ka miratuar 2 Rregullore dhe 6 Vendime, dhe kuvendi i komunës së Mamushë ka miratuar 3 rregullore dhe 7 Vendime.

Lidhur me përgjegjësitë e komunave për informim të drejtë të qytetarëve lidhur me aktivitetet e kuvendeve të komunave, në faqen zyrtare të komunave janë postuar informacione të përgjithshme lidhur me aktivitetet e kryetarëve të komunave dhe kuvendeve të komunave.

Publikimi i akteve

Komuna e Prizrenit nga 17 akte sa ka miratuar gjatë kësaj periudhe i ka te publikuara 12 akte në gjuhët zyrtare, ndërsa 5 akte nuk i ka publiku. Komuna e Deçanit i ka te publikuara aktet e miratuar nga kuvendi i komunës në faqen zyrtare të komunës, por vetëm në gjuhen shqipe. Komuna e Obiliqit i ka të publikuara vetëm 3 aktet në gjuhën shqipe, nga 19 gjithsej sa i ka të miratuar në këtë periudhë. Ndërsa komuna e Junikut dhe Mamushës nuk kanë publikuar asnjë akt të kuvendit të komunës gjatë kësaj periudhe të raportimit.

Sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 58, pikës (j), kryetari i Komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunë për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës. Në komën e Junikut dhe Prizrenit kanë raportuar kryetaret e komunave para anëtareve të kuvendit nga një here gjatë kësaj periudhe lidhur më situatën ekonomiko-financiare të komunës.

Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave

Gjatë kësaj periudhe, informimi dhe komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt. Sa i përket krijimit të kushteve për shqyrtimin administrativ të akteve komunale nga organet mbikëqyrëse si formë e veçantë e autorizimeve kontrolluese, dërgimi i akteve komunale ka qenë i rregullt nga këto komuna dhe në afatin e përcaktuar ligjor.

Në këtë periudhë nga gjithsej 61 akte të miratuara, 32 prej tyre janë konfirmuar të ligjshme, ndërsa 29 të tjera janë dërguar në Ministritë e linjës përkatësisht Komisionet për shqyrtim të ligjshmërisë. Natyra e akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë nga fusha financiare, si miratimi i propozim buxhetit, rregulloret për tatimin në pronë, rregullore për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, gjithashtu i përket fushës së mjedisit si dhe akte të karakterit organizativ dhe funksional të komunës.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe puna e mekanizmave konsultativ në fushën e sigurisë publike, siç është Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili themelohet nga kuvendi i komunës ndërsa kryesohet nga kryetari i komunës. Në të gjitha komunat e lartcekura është themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, konform Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012-MPB Nr.03/2012-MAPL për Themelimin dhe Funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Më poshtë kemi paraqitur numrin e takimeve të mbajtura të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi:



Fig.34. *Takimet e Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi: Prizren, Mamushë, Junik, Obiliq dhe Deçan*

Nga figura e mësipërme shihet se KKSB në komunat e lartë cekura kanë mbajtur 6 takime. Komuna e Deçanit ka mbajtur 2 takime, ndërsa komunat e Prizrenit, Mamushës, Obiliqit dhe Junikut nga 1 takim.

Ndër çështjet më të shpeshta që janë diskutuar në këto takime ishin çështja e sigurisë publike në komunë, ku në përgjithësi u cilësua situatë e qetë nëpër komunat e lartcekura. Në veçanti u potencua një shqetësim në komunën e Deçanit nga komandanti i policisë së kësaj komune, që kishte të bënte me vjedhjet. Poashtu u diskutua edhe mbyllja e lojërave të fatit me rekomandim te KKSB në komunën e Deçanit, mirëpo të njëjtat janë hapur përsëri më lejen e ATK-së.

Në mbledhjet e rregullta të KKSB në Obiliq u diskutua ndër të tjera edhe për sigurinë në komunën e Obiliqit, e cila u cilësua e qetë dhe ka shënuar rënie të rasteve negative në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjithashtu u diskutua në lidhje me menaxhimin e krizës, pas shpërthimit të elektrolizës në Termocentralin Kosova A në Obiliq. Ka edhe çështje tjera të cilat janë diskutuar, e që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sigurinë publike në komunë.

Të gjeturat kryesore

- Publikimi i akteve të organeve të komunës nuk bëhet sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Rregulloren Nr. 01/2013 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), nuk dërgohen në MAPL, sipas dispozitave ligjore të përcaktuara më Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012MPB–03/2013 MAPL për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Nuk është emëruar Nënkryetari i komunës për komunitet në komunën e Prizrenit;
- Nuk janë të regjistruara dhe të publikuara në faqen zyrtare të komunës pronat e paluajtshme të komunës që janë të dedikuara për dhënien në shfrytëzim;
- Nuk dërgohet në MAPL, nga kryetarët e komunave lista e akteve të miratuara nga organet e komunës, konform dispozitave të nenit 81të LVL-së;
- Nuk janë themeluar nga kuvendi i komunës, Komitetet Konsultative konform Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 73.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

- Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e miratimit të akteve juridike nënligjore.
- Komunat të shfrytëzojnë mundësinë e konsultimit paraprak, para miratimit të akteve.
- Të respektohen kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve në afatin e paraparë ligjor.
- Komunat të njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
- Të zbatohen praktikat më të mira për informim, për mbledhjet e kuvendeve të komunave dhe takimeve publike.
- Komunat të dërgojnë brenda afateve ligjore aktet e miratuara për vlerësim të ligjshmërisë, konform nenit 81.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
- Të mirëmbahen dhe funksionalizohen pajisjet elektronike për monitorim të mbledhjeve të kuvendeve të komunave dhe të vendosen konform U.A Nr. 2012/01 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative "Teleprezencave" (Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Pejë, Suharekë dhe Zveçan).
- Kryetarët e komunave të dërgojnë listën e akteve të miratuara nga organet e komunave, konform nenit 80.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duke përjashtuar komunat: Gjilan, Mitrovicë Jugore, Prizren, Gllogoc, Vushtrri.
- Të funksionalizohet Komiteti për Komunitete në komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Ndërsa, të fuqizohet më tepër në: Junik, Mamushë, Podujevë, Obiliq, Novobërdë, dhe Deçan.
- Kryetarët e komunave: Klinë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Malishevë, të raportojnë para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës (sipas nenit 58, pika (j) të LVL-së).
- KKSB të themelohet në: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan.
- Aktet e miratuara nga organet e komunave të publikohen në linkun e përcaktuar për publikim në faqet zyrtare të komunës, konform Rregullore Nr. 01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave.
- Të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSB-ve në MAPL dhe MPB sipas U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB.